

**IN MEMORIAM****SKËNDER KOJA – PEDAGOG, DREJTUES DHE  
INTELEKTUAL I SHQUAR****FLORAN VILA.<sup>1</sup>, FATOS YLLI.<sup>2</sup>**

<sup>1</sup>Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Fizikës

<sup>2</sup>Universiteti i Tiranës, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar

**9.10.1929 – 25.10.2018**

Skënder Koka i përket atij brezi të pedagogëve të talentuar që studimet e larta i kryen jashtë shtetit, në vitet e para mbas çlirimit të Shqipërisë dhe pak më vonë u bënë pjesëtarë të denjë të atij profesorati të nderuar, që themeloi Universitetin e Tiranës.

Lindi në Tiranë më 9 Tetor 1929, në një familje qytetare tiranase, me tradita patriotike e arsimdashëse. Gjyshi tij Pavllo Koja, i njohur për bujarinë, ishte ndër financuesit e shkollës së parë shqipe në Tiranë, ndërsa familja e nënës së tij, familja Nosi nga Elbasani, ishte një ndër familjet e shquara patriote elbasanase, që kontriboi në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, më 1912.

Traditat e edukuara që në fëmijëri nga familja, e shoqëruan Skënderin gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij intelektuale e shoqërore.

Mbaroi gjimnazin e Tiranës në vitin 1949, vit në të cilin u dërgua për studime në Poloni, në Universitetin Politeknik të Varshaves. Pasi mbaroi studimet dhe u diplomua në degën e fizikës, më 1953, u kthye në Shqipëri dhe u emërua pedagog i fizikës në Institutin e Lartë Pedagogjik.

Me krijimin, e Universitetit të Tiranës, më 1957, u emërua pedagog i fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, duke u bërë një ndër pedagogët e parë që në themelimin e tij.

Me 1959-61 u dërgua në Universitetin e Moskës, për të kryer studimet e aspiranturës (pasuniversitare) në fushën e fizikës së aplikuar. Tema e studimit ishte “Projektimi i një burimi jonik për studimin e dispersionit katodik në kristale”, studim i cili i zgjeroi mjaft njohuritë duke e bërë një studiues të kompletuar në fushën e fizikës.

Në vitin 1963 iu akordua titulli docent dhe më pas, më 1965 u emërua shef i Katedrës së Fizikës së Përgjithshme, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Në fakultet të gjithë kolegët e tij e kujtojnë si një pedagog të devotshëm, mjaft të aftë nga ana profesionale dhe të talentuar. Ai ishte mjaft i zoti në aspektin metodik në mësimdhënien e fizikës dhe i pari pedagog, që me komentet dhe interpretimet e tij fizike, i bëri formulat që të “flasim me fjalë”. Gjithashtu ai krijoi një klimë shumë të mirë pune dhe mirëkuptimi, si me studentët ashtu dhe me anëtarët e Katedrës, duke inkurajuar kualifikimin e tyre nëpërmjet seminareve dhe punës kërkimore shkencore.

Duke i dhënë rëndësi mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ai ka botuar disa libra, ku ndër të tjera përmendim Teoria Speciale e Relativitetit dhe Disa Metoda Matematike në Fizikë.

Në vitet 60 u iniciua ideja për krijimin e një Qendre Kërkimore Zbatuese në fushën e fizikës atomike dhe bërthamore. Kontributi i Skënder Kojës, bashkë me kontributin e bashkëpunorëve të tij Petrit Skënde dhe Flamur Zela, në këtë drejtim ishte shumë i rëndësishëm.

Pas një specializimi më 1969, në fushën e zbatimit të teknikave bërthamore në Institutin e Fizikës Atomike të Bukureshtit, ai u angazhua në krijimin e Labororit të Rrezatimeve Bërthamore.

Më 1970, me ngritjen e këtij Laborori në nivel Instituti dhe kalimit të tij në varësi të Universitetit të Tiranës dhe më pas të Akademisë së Shkencave, ai mbajti detyrën e drejtorit të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të shefit të Katedrës së Fizikës së Përgjithshme në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.

Si drejtor i Institutit ai kontriboi me devotshmëri dhe profesionalizëm të lartë në ngritjen e një Qendre Kërkimore Aplikative, me strukturë dhe objektiva bashkëkohore, nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave matëse dhe analitike, si dhe duke i vënë theks të veçantë kualifikimit sa më të plotë të punonjësve të tij. Në sajë të një pune kolektive, Instituti u transformua në një qëndër ekselence me reputacion të lartë në komunitetin shkencor të asaj kohe. Ai e drejtoi Institutin me aftësi, duke vënë në shërbim të tij të gjithë kapacitetin intelektual dhe shoqëror.

Më 1979 kreu një specializim në fushën e reaktorëve eksperimentalë në Romë, Itali. Mbi këtë bazë filloi projekti i mbështetur nga UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) dhe IAEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike), për ngritjen e një reaktori bërthamor kërkimor në Shqipëri. Pas përfundimit të detyrës si drejtor i Institutit, ai vazhdoi të punojë po me aq entuziazëm si shef i Sektorit të Elektronikës Bërthamore.

Pas daljes në pension më 1989, ai vazhdoi të jetë aktiv në fushën e mësimdhënies në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Ka përfaqësuar me dinjitet Shqipërinë në shumë konferenca ndërkombëtare të energjisë atomike në Vienë, Austri. Është dekoruar dy herë me Urdhërin Naim Frashëri të klasit të parë dhe të dytë, si dhe i është akorduar titulli “Punonjës i Shquar i Shkencës dhe Teknikës”.

Duke mos qënë indiferent ndaj zhvillimeve demokratike në vend, ai vazhdoi të kontribuojë me njohuritë dhe idetë e tij në zhvillimin e arsimit dhe shkencës.

Të gjithë kolegët, dashamirësit dhe familjarët e tij, do ta kujtojnë Skënder Kojën si një intelektual të shquar, një njeri me kulturë të gjërë, që e deshi artin, muzikën, shkencën dhe veçanërisht fizikën.